

VENDIM
Nr. 296, datë 24.4.2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 789, DATË 15.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRITERET, MËNYRËN E SHPËRBLIMIT DHE TRAJTIMIN E SPORTISTËVE, QË PËRFITOJNË STATUSIN E NIVELIT TË LARTË, DHE TRAJNERËVE TË TYRE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 27, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 789, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, dhe trajnerëve të tyre”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 4, masa “... 40 (dyzet) % ...” zëvendësohet me “... 70 (shtatëdhjetë) % ...”.

2. Pika 4/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4/1. Sportisti shpërblehet financiarisht vetëm për një rezultat sportiv të arritur për secilën nga veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare: lojëra olimpike, kampionat botëror, kampionat evropian, lojëra mesdhetare dhe kampionat ballkanik, gjatë vitit kalendarik, në një disiplinë, sipas tabelës I. Në sportet individuale, të cilat kanë stile të veçanta dhe më pas një rezultat përfundimtar, shpërblimi për çdo stil të veçantë do të jetë në masën 65%, me kushtin që të jetë i klasifikuar në rezultatin përfundimtar, si dhe 100% për rezultatin përfundimtar.”.

3. Pas pikës 4/1 shtohet pika 4/2, me këtë përmbajtje:

“4/2. Në sportet individuale, ku garimi është në çift ose ekipor, shpërblimi do të akordohet sipas tabelës I dhe do të përpjesëtohet sipas numrit të pjesëmarrësve. Sportet joolimpike shpërblehen sipas tabelës I, kur në kampionatin botëror garojnë më shumë se 8 (tetë) sportistë, në kampionatin evropian ka më shumë se 6 (gjashtë) sportistë, në lojërat mesdhetare, më shumë se 4 (katër) sportistë, dhe në kampionatin ballkanik, më shumë se 4 (katër) sportistë.”.

4. Në pikën 7, masa “... 40 (dyzet) % ...” zëvendësohet me “... 50 (pesëdhjetë) % ...”.

5. Në pikën 9, fjalët “... jo më pak se 3 500 (tre mijë e pesëqind) lekë ...” zëvendësohen me “... jo më pak se 5 000 (pesë mijë) lekë ...”.

II. Tabela I, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Shënimet në tabelën I, bashkëlidhur vendimit në fuqi, shfuqizohen.

III. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 prill 2026.

IV. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe organizatat sportive shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VEPRIMTARITË NDËRKOMBËTARE ZYRTARE

Tabela I

Veprimtaria	Rezultati	Masa e shpërblimit
	Rekord olimpik	18 000 000 lekë
	Rekord botëror	15 000 000 lekë
	Rekord evropian	6 000 000 lekë
	Rekord mesdhetar	3 000 000 lekë
	Rekord ballkanik	1 500 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i parë	15 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i dytë	13 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i tretë	10 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i katërt	6 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i pestë	4 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i gjashtë	2 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i shtatë	1 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i tetë	800 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i parë	10 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i dytë	7 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i tretë	5 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i katërt	3 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i pestë	2 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i gjashtë	1 500 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i shtatë	800 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i tetë	600 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i parë	6 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i dytë	4 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i tretë	3 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i katërt	1 500 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i pestë	1 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i gjashtë	500 000 lekë
Lojëra mesdhetare	Vendi i parë	3 000 000 lekë
Lojëra mesdhetare	Vendi i dytë	2 000 000 lekë
Lojëra mesdhetare	Vendi i tretë	1 000 000 lekë
Kampionati ballkanik	Vendi i parë	1 500 000 lekë